



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
AUTORITETI KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE
SIGURINË KIBERNETIKE**

**METODOLOGJI
PËR IDENTIFIKIMIN DHE
KLASIFIKIMIN E INFRASTRUKTURAVE KRITIKE
DHE INFRASTRUKTURAVE TË RËNDËSISHME TË
INFORMACIONIT**

Miratuar me Urdhër nr.9 datë 14/02/2022

Tabela e përmbajtjes

1. HYRJE.....	1
2. KRITERET DHE FAKTORËT E KLASIFIKIMIT.....	1

1. HYRJJE

Rrjetet e komunikimit janë një komponent i rëndësishëm i jetës së qytetarëve. Këto rrjete paraqesin strukturën e shoqërisë së informacionit dhe ofrojnë mjetet për një treg të vetëm dixhital. Disa pjesë të këtyre rrjeteve të komunikimit janë gjithashtu jetike për operacionet e Infrastrukturave Kritike, të cilat janë themelore për funksionimin e shoqërisë.

Infrastrukturat Kritike si, energjia elektrike, shëndetësia apo sistemet e transportit publik varen nga funksionimi korrekt i rrjeteve të komunikimit që mbështesin funksionimin e tyre. Këto sisteme dhe rrjetet mbështetëse, që do t'iu referohemi si Infrastrukturë Kritike e Informacionit, përbëjnë shtyllat kryesore për funksionimin e ekonomisë dhe shoqërisë.

Shqipëria, si një vend në zhvillim, mbështetet gjithashtu, në teknologjinë e informacionit, duke synuar rritjen e nivelit të jetesës dhe përmirësimin e shërbimeve publike. Krahas përfitimeve nga përdorimi i teknologjive të reja digjitale, përdorimi i internetit sjell problematikat e veta në lidhje me sigurinë kibernetike. Kërcënimet kibernetike, duke përfituar nga dobësitë teknologjike ose mungesa e njohurive në përdorimin e mirë të këtyre mjeteve, janë gjithnjë e më shumë në rritje, duke cënuar sigurinë e sistemeve të informacionit

Në zbatim të ligjit Nr. 2/2017 për “Sigurinë Kibernetike”, neni 6, pika 2, Këshilli i Ministrave, miraton listën e infrastrukturave kritike të informacionit dhe të infrastrukturave të rëndësishme të informacionit, e cila përditësohet të paktën një herë në dy vjet.

Identifikimi i infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit bazohet në një metodologji dhe bllokskëmë, të cilat janë bazuar kryesisht në praktikat më të mira të CERT-it European (ENISA) dhe homologëve evropiane. Metodologjia, për përcaktimin e infrastrukturave kritike e të rëndësishme të informacionit do të bazohet në dy elementë : faktorët (sipas efektit financiar, kohë dhe shpërndarje gjeografike) dhe kriteret (sipas ndikimit në ekonomi, politikë, mjedisor, shëndetësor).

2. KRITERET DHE FAKTORËT E KLASIFIKIMIT

Sipas ENISA, kriteret dhe faktorët për identifikimin dhe klasifikimin e infrastrukturave të informacionit mund të listohen si më poshtë:

Kriteret	Faktorët
Ndikimi Ekonomik	Efkti financiar
Ndikimi politiko/qeveritar	Efkti në kohë
Ndikimi industrial/mjedisor	Shpërndarja gjeografike
Ndikimi shëndetësor	

Plani i punës deri në përcaktimin e listës së shërbimeve, operatorëve dhe sektorëve të CII-ve parashtrohet si më poshtë:

- 1) Përcaktimi i qëllimeve dhe politikave
- 2) Identifikimi i operatorëve të Infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit
- 3) Përcaktimi i kriterëve të kritikalitetit
- 4) Identifikimi i infrastrukturave të informacionit
- 5) Identifikimi i sektorëve të Infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, nënsektorëve, operatorëve dhe shërbimeve të tyre.

Sektori	Nësektori	Shërbimet
1. Energjia	Elektriciteti	<ul style="list-style-type: none"> • I përgjithshëm (të gjitha format) • Transmetimi / Shpërndarja • Operatorët e energjisë elektrike
	Nafta	<ul style="list-style-type: none"> • Nxjerrja • Rafinimi • Transporti • Ruajtja
	Gazi natyral	<ul style="list-style-type: none"> • Nxjerrja • Transporti / Shpërndarja • Ruajtja
2. Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (ICT)	Teknologjia e Informacionit	<ul style="list-style-type: none"> • Webservices (Shërbime në internet) • Datacenter / shërbime në cloud • Software as a service
	Komunikimi	<ul style="list-style-type: none"> • Voice / data communication (Komunikimi me zë / të dhëna) • Internet Connectivity (Lidhja e internetit)
3. Uji	Uji i pijshëm	<ul style="list-style-type: none"> • Ruajtja e ujit • Shpërndarja e ujit • Sigurimi i cilësisë së ujit
	Ujërat e zeza	Grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të zeza

4. Ushqimi		<ul style="list-style-type: none"> • Bujqësia / prodhimi i ushqimit • Furnizimi me ushqim • Shpërndarja e ushqimit • Cilësia / siguria e ushqimit
5. Shëndetësia		<ul style="list-style-type: none"> • Kujdesi shëndetësor • Kujdesi spitalor (spitalor & ambulator) • Furnizimi me produkte farmaceutike, vaksina, gjak, pajisje mjekësore • Kontrolli i infeksionit / epidemisë
6. Shërbime financiare	Bankar Mikrofinancat Tregu i Siguracioneve Bursa (Stock Exchange)	Transaksionet e pagesës
7. Rendi dhe Siguria Publike		<ul style="list-style-type: none"> • Mirëmbajtja e rendit dhe sigurisë publike • Gjyqësori dhe sistemet penale
8. Transporti	Transporti ajror	<ul style="list-style-type: none"> • Air navigation services • Airports operation
	Transporti rrugor	<ul style="list-style-type: none"> • Shërbime autobusi / tramvaji • Mirëmbajtja e rrjetit rrugor
	Transporti hekurudhor	<ul style="list-style-type: none"> • Menaxhimi i hekurudhës publike • Shërbimet e transportit hekurudhor
	Transporti detar	<ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi dhe menaxhimi i transportit detar
	Shërbimi postar / Shipping	
9. Industria	Industria kimike / nukleare	<ul style="list-style-type: none"> • Magazinimi dhe asgjësimi i materialeve të rrezikshëm • Siguria e njërive industriale me rrezik të lartë
10. Administrata civile		Funksionet qeveritare

11. Hapësira		Mbrojtja e sistemeve të bazuara në hapësirë
12. Mbrojtja civile		Shërbimet e emergjencës dhe shpëtimit
13. Mjedisi		Monitorimi i ndotjes së ajrit dhe paralajmërimi
		<ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi meteorologjik dhe paralajmërimi • Monitorimi dhe paralajmërimi i ujërave nëntokësore (liqen / lumë) • Monitorimi dhe kontrolli i ndotjes detare
14. Mbrojtja		Mbrojtja kombëtare

Indikatorët e nevojshëm që duhet të maten për të identifikuar infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme janë:

- 1) Efekti financiar – ndikimi financiar që shkaktohet kur infrastruktura është jashtë funksionimit
- 2) Shpërndarja gjeografike – numri i individëve që mund të ndikohet nga mosfunksionimi i infrastrukturës
- 3) Efekti i kohës – përcaktohet në orë, ditë, muaj dhe vite, i cili tregon impaktin që një shërbim do ketë në humbje kur është jashtë funksionimit

Identifikimi i infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit:

- Operatorët e infrastrukturave deklarojnë pranë AKCESK indikatorët/informacionin, për kriteret dhe faktorët e klasifikimi.
- AKCESK bazuar në indikatorët/informacionin e deklaruar nga operatorët e infrastrukturave, në përputhje me “*Bllokskemën e Identifikimit të Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit*” analizon dhe kategorizon infrastrukturat e informacionit, si kritike dhe të rëndësishme, sipas kriterëve dhe faktorëve të përcaktuar në pikën 2 të kësaj metodologjie.